

# Indeksi i Sigurisë së Grave 2010: Raport për Kosovën

Botuese: Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Drejtores e projektit: Luljeta Vuniqi

Shkruar nga: Kushtrim Shaipi

Menaxhere e projektit: Luljeta Demolli

Redaktimi Teknik, Dizajni dhe Shtypi: Drin Kryeziu

© 2011 Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)

Të gjitha të drejtat e rezervuara

[www.kgscenter.net](http://www.kgscenter.net)

Porositur nga: Porositur nga: Grupi Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore dhe financiarisht e mbështetur nga UN Women



Qendra Kosovare për Studime Gjinore  
Kosovar Gender Studies Centre

Ky raport është financiarisht i mbështetur nga UN WOMEN por pikëpamjet e prezantuara në këtë studim nuk reflektojnë ato të UNWOMEN



---

# Përmbajtja

FALËNDERIME	5
SHKURTESAT	6
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	7
NOTA SHTETËRORE	9
GJENDJA AKTUALE	11
SIGURIA NJERËZORE	15
PËRFSHIRJA POLITIKE DHE INSTITUCIONALE	24
INFORMATA TEKNIKE	26
Sfondi i Projektit	26
Qëllimi dhe Shfrytëzimi	27
Fushëveprimi	28
Metodologjia e Projektit	28
ANEKSI 1: Indikatorët për Rangim Personal	33
Udhëzime për Panelistët:	33
ANEKSI 2: Lista e Pjesëmarrësve në Panelet e Ekspertëve	36



---

## FALËNDERIME

I tërë ekipi i projektit do të dëshironin të falënderonin kontributin e të gjithë ekspertëve në panele, pasi që indeksi është gjerësisht i bazuar në komentet e mbledhura nga ekspertët. Ekspertët që kanë konsultuar ekipin gjatë zhvillimit të metodologjisë duhet gjithashtu të përmenden për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm për këtë projekt.

Porositur nga Grupi Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore

Ky projekt është bërë i mundur  
nga mbështetja bujare e UN Women.



## SHKURTESAT

<b>ADL</b>	• Ligji Kundër Diskriminimit
<b>CEDAW</b>	• Komiteti mbi Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave
<b>KP</b>	• Policia e Kosovës
<b>KPC</b>	• Forca e Sigurisë së Kosovës
<b>KSF</b>	• Forca e Sigurisë së Kosovës
<b>PD</b>	• Dokumentet e Qëllimit
<b>PKD</b>	• Partia Demokratike e Kosovës
<b>EU</b>	• Bashkimi Evropian
<b>EULEX</b>	• Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
<b>NGO</b>	• Organizatat Joqeveritare
<b>ICO</b>	• Zyra Civile Ndërkombëtare
<b>SGCG</b>	• Grupi Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore
<b>SOK</b>	• Zyra Statistike e Kosovës
<b>SRS</b>	• Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral
<b>SWC</b>	• Qendra e Punës Sociale
<b>UNIFEM</b>	• Fondi Zhvillues për Gra i Kombeve të Bashkuara
<b>UNDP</b>	• Fondi Zhvillues i Kombeve të Bashkuara
<b>UNFPA</b>	• Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara
<b>USAID</b>	• Agjencioni për Zhvillim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës
<b>WHO</b>	• Organizata Botërore Shëndetësore
<b>WSI</b>	• Indeksi i Sigurisë së Grave

---

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Indeksi i Sigurisë së Grave është një metodologji e re e zhvilluar me qëllim të matjes së sigurisë së grave përgjatë 6 dimensioneve/llojeve të sigurisë, secila e matur përmes indikatorëve specifik. Metodologjia, e cila është zhvilluar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe IQ Consulting, është duke u pilotuar për herë të parë në Kosovë, dhe testimi tregon se sipas të gjitha gjasave mund të replikohet edhe në shtete tjera. Ai është zhvilluar gjithashtu në bazë të indikatorëve për monitorim dhe implementim të UNSCR 1325, e cila përfshin gjithsejtë 26 indikatorëve specifik<sup>1</sup>

Ushtrimi është kryer përmes tri Diskutimeve të Paneleve të Ekspertëve, një me secilin përfaqësues të Medies, Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Publike. Një diskutim shtesë është bërë me Grupin Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore(GKSGj). E sapopërmendura nuk është pjesë e metodologjisë së standardizuar, por është kryer pasi që stafet e projektit mendojnë se kontributi i këtij grupi është shumë i rëndësishëm. Gjithsejtë, rreth 30 ekspertë të sektorëve të ndryshëm kanë marrë pjesë në ushtrim. Disa nga stratifikimet e mostrave të ekspertëve të përdorura për të siguruar përfaqësim kanë qenë sektori, lokacioni (qendër-periferi), përvoja dhe lloji i ekspertizës.

Notimi i përgjithshëm shtetëror për Kosovën në Indeksin për Sigurinë e Grave 2010 është 3.41. Ky notim e vendos Kosovën në mes të notës 7.00 të shkallës së notimit, duke treguar se, përkundër faktit se shumë është arritur në sigurimin e sigurisë së grave, prapë mbetet punë e madhe për t'u bërë. Dimensionin më i notuar pozitivisht është Arsimi, i cili është ranguar me 3.06 në 7.00 shkallë. Ndryshe nga kjo, dimensionin më i notuar negativisht është Siguria Ekonomike, i cili është ranguar me 4.16.

Qasja e barabartë në arsim, mosdiskriminimi në regjistrim dhe vlerësimi/notimi kanë qenë arsyt kryesore pse panelet e ekspertëve kanë ranguar këtë dimension aq lartë. Në anën tjetër, praktikata e dobëta të trashëgimisë, qasja jo e barabartë në tregun e punës, dhe zbatimi i dobët i drejtave të alimonisë kanë shkaktuar që Dimensionin i Sigurisë Ekonomike të rangohet më së keqi.

Në ngjarjet e fundit politike dhe institucionale gratë kanë luajtur një rol të

---

<sup>1</sup> Indikatorët mund të gjenden në uebfaqen zyrtare të UN: [http://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=S/2010/173](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2010/173)

rëndësishëm. Kriza e zgjedhjes së presidentit është zgjidhur duke zgjedhur një grua për presidente, për herë të parë në Kosovë dhe në rajon. Procesi më i ndjeshëm politik dhe i ndërtimit të paqes është duke u drejtuar nga një grua. Një prej masave më të rëndësishme qeveritare për të vendosur kontroll në pjesën veriore të vendit është marrë nga një grua.

Pilot ushtrimi i metodologjisë është kompletuar me shumë sukses. Është mendimi i autorëve të metodologjisë dhe tërë stafit të projektit, se metodologjia është testuar me sukses dhe duhet të ndërmerret veprim i menjëhershëm për të replikuar ushtrimin në shtete tjera, në këtë mënyrë duke kontribuar në një monitorim të strukturuar të indikatorëve të sigurisë së grave në një rajon më të gjerë gjeografik, madje edhe globalisht.


Ky raport është mbështetur financiarisht nga UN -Women. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë studim nuk i pasqyrojnë ato të UN- Women.



## NOTA SHTETËRORE

Nota totale shtetërore për Kosovën është caktuar si rezultat i të gjitha Diskutimeve të Paneleve të Ekspertëve dhe rangimeve individuale të mbi 30 ekspertëve nga institucionet publike, organizatat vendore dhe ndërkombëtare, dhe sektorët e medias. Vlera mesatare e gjashtë dimensioneve që definojnë këtë indeks gjithsejtë është 3.41. Vlerat individuale të dimensioneve janë prezantuar në Ilustrimin 1. më poshtë.

### Indeksi i sigurisë së grave në Kosovë




### Ilustrimi 1. Indeksi Kosovari i Sigurisë së Grave

Ashtu siç mund të pritet, notat e nxjerra nga grupet e ndryshme të ekspertëve shpesh dallojnë substancialisht. Si trend qartësisht i observueshëm, gazetarët kanë tendencë të jenë më kritikët në notimin e tyre individual, si dhe sa i përket perceptimeve rreth gjendjes që lidhet me indikatorët dhe dimensionet e ndryshme. Pas tyre janë ekspertët e shoqërisë civile të cilët e pranojnë progresin që është bërë, por mbesin mjaft kritik. Perceptimet më optimiste vijnë nga përfaqësuesit institucional të cilët gjatë diskutimeve kanë qenë mjaft të vendosur në argumentimin e pozicioneve të tyre dhe notimin individual. Ilustrimi 2 më poshtë përfaqëson dallimin në notim të nxjerrur nga të tri grupet.

Siç mund të shihet në Ilustrimet 1 dhe 2, ekspertët e të gjitha grupeve besojnë se gjendja më e avancuar, sa i përket dimensioneve të sigurisë së grave nga indeksi, është Arsimi, i cili është ranguar me 3.06. Në anën tjetër, sa i përket sigurisë së grave në Kosovë, Siguria Ekonomike është ranguar si aspekti më i keq.

### Indeksi i sigurisë së grave në Kosovë sipas paneleve të ekspertëve



### Ilustrimi 2. Rangimi Kosovar sipas paneleve

---

## GJENDJA AKTUALE

Sa i përket zhvillimeve politike që nga shpallja e pavarësisë, muajt e fundit e kanë përbërë periudhën më vibrante për shtetin më të ri në Evropë, dhe gratë kanë luajtur rol të rëndësishëm në të gjitha proceset. Me një proces të stërzgatur zgjedhor presidencial dhe në ndërtimin e koalicionit, qeveria është formuar nga partia fituese e zgjedhjeve – PDK me Aleancën për Kosovë të Re të z. Behgjet Pacolli dhe partive të komuniteteve minoritare. Koalicioni pësoi goditjen e parë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Kosovës z. Behgjet Pacolli. Situata e re dërgoi në negociata të zgjatura dhe rrugë pa krye sa i përket pozitës së Presidentit. Një president konsensual u zgjedh vetëm pas presionit të vazhduar ndaj Kryeministrit z. Hashim Thaçi, nga një numër i akterëve ndërkombëtar prezent në Kosovë. Pas arritjes së konsensusit, Parlamenti i Kosovës votoi znj. Atifete Jahjaga si gruaja e parë për të zënë postin më të ranguar publik në Kosovë.

Sfida e parë e koalicionit të brishtë të qeverisë erdhi menjëherë pas zgjedhjeve dhe kjo përfshiu një proces të komplikuar me Serbinë. Procesi u portretizua si dialog mbi çështje teknike që dy fqinjët duhet t'i zgjidhin në favor të përmirësimit të jetës së qytetarëve, përdërisa në Serbi e njëjta u konsiderua si një proces që do t'u sjellë atyre statusin e Kandidatit për Anëtarësim në BE.

Udhëheqëse e Delegacionit Kosovar në dialog me Serbinë u caktua Zëvendëskryemistrja znj. Edita Tahiri, gruaja e dytë që do të luan një rol kyç në proceset e nivelit të lartë politik. Procesi ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe sponzorohet nga e njëjta, si emërues i përbashkët i qëndrimit konsensual të 27 anëtarëve. Roli i BE-së në proces nuk ka qenë pozicion shumë i favorshëm, duke konsideruar se për Serbinë statusi Kandidat u përdor si shkop dhe karotë, përdërisa për Qeverinë e Kosovës nuk pati asnjë ofertë, sepse kjo e fundit nuk e ka të qartë as prospektin potencial për heqjen e regjimit të vizave për shtetet Shengen, si hapi i parë në procesin e integritimit. Duke pasur pesë anëtarë që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, kjo ka ndikuar që Bashkimi Evropian të mos mund të adaptoj një politikë më të qartë karshi Kosovës.

Përdërisa për dialogun thuhet që është produktiv dhe shpie në disa marrëveshje konkrete dhe rezultate pozitive, i tërë procesi u ndal kur Serbia refuzoi të njoh Vulat e Doganave të Kosovës, një çështje kjo në të cilën Qeveria e Kosovës insistoi. Moszgjidhja e kësaj çështjeje e la numrin e vogël të

---

eksportuesve kosovar me qasje jo të lehtë në tregjet perëndimore. Përkundër kërkesave të shumta të Qeverisë së Kosovës tek autoritetet ndërkombëtare duke përfshirë CEFTA-n, ku të dy palët janë nënshkruese, problemi mbetet ende që nga deklarimi i pavarësisë.

Dështimi për të arritur një marrëveshje sa i përket Vulave të Doganave si dhe shtyrja e dialogut për shtator, dhe sinjalet e qarta nga Serbia se nuk do të bëjë kompromis në pozicionet e tyre, sjelli në skenë një grua tjetër. Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë znj. Mimoza Kusari-Lila, propozoi një vendim qeveritar për të vendosur masa të reciprocitetit kundrejt Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, që nënkuptonte se asnjë mall që ka origjinë nga Serbia nuk mund të futet në Kosovë, përderisa ato nga Bosnja dhe Hercegovina do të ngarkoheshin me 10përqindje tatim importi. Pas marrjes së këtij vendimi, Qeveria e Kosovës u gjend përballë edhe një sfide tjetër madhore. Vendimi ishte i vështirë për t'u implementuar në pjesën veriore të Kosovës, të banuar kryesisht me popullatë serbe, ku nuk ka pasur prezencë të Qeverisë së Kosovës që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Gjatë asaj kohe, serbët lokal patën djegur pikëkalimet kufitare 1 dhe 31, duke krijuar kështu strehë "pa dogana" për trafikues të të gjitha etniteteve që i shkaktuan buxhetit të Kosovës humbje në qindra miliona euro në të hyra.

Si hap në implementimin e masave të reciprocitetit kundrejt Serbisë, Kryeministri Thaçi autorizoi një aksion të njësisë speciale të policisë së Kosovës për të rivendosur prezencën në pikëkalimet kufitare 1 dhe 31, si dhe pas refuzimeve të vazhdueshme për asistencë nga EULEX-i, Misionit për Sundim të Ligjit të BE-së, që ka funksione ekzekutive në disa fusha. Plani disi u zbulua dhe njësitë policore u zunë në pritë nga serbë lokal të armatosur që shkaktuan vdekjen e një polici dhe plagosjen e disa të tjerëve. Në tentimin e dytë policia speciale morri kontrollin e dy pikëkalimeve kufitare, por pa ndonjë vizion se si të vazhdohet tutje. Serbët lokal, të drejtuar nga 'autoritetet paralele' të Republikës së Serbisë prezente në këtë pjesë të Kosovës, bllokuan rrugët që çojnë në pikëkalimet si shenjë proteste ndaj intervenimit. Gjatë kohës sa tensionet ishin të larta, kishte gjuajtje nga snajperë, të cilët në shënjestër kishin helikopterët e KFOR-it, i cili ishte akteri i parë ndërkombëtar që reagoi ndaj situatës së krijuar, duke dërguar një numër më të madh të ushtarëve për ta qetësuar situatën. Dërgimi i ushtarëve të KFOR-it në terren mundësoi tërheqjen e forcave speciale të policisë së Kosovës, dhe në të njëjtën kohë vendosi kontroll në pikëkalimet kufitare veriore dhe mundësoi implementimin e masave të reciprocitetit përgjatë territorit të Kosovës. Gjatë kohës së raportimit, tensionet janë në rënie për shkak të aktivitetit të shtuar të KFOR-it, por zgjidhja finale e kësaj situatë do të arrihet ose përmes

---

mekanizmave të CEFTA-s ose përmes dialogut, që kërkohet të vazhdohet nga BE-ja.

Nga një aspekt tjetër, zhvillimi ekonomik dhe zhdukja e varfërisë gjithashtu përbëjnë dy nga çështjet më urgjente për kosovarët. Gratë përbëjnë një prej grupeve më të pafavorizuara në ekonomi. Një dëshmi e situatës së pafavorshme të grave është përhapja e varfërisë, ku gratë, që jetojnë në varfëri, përbëjnë 70 përqindje të të papunëve. Një indikacion tjetër i diskriminimit ekonomik ndaj grave është përqindja shumë e kufizuar e grave që posedojnë pronë, ku llogaritet se vetëm 8 përqindje e pronës së paluajtshme dhe 6 përqindje e kompanive private janë në pronësi të grave. Pjesëmarrja e grave në ekonomi është ndër më të ulëtat në Evropë, me vetëm 35 përqindje të grave që marrin pjesë aktive në tregun e punës. Për më tepër, gratë rrallë posedojnë pronë dhe shpesh privohen nga e drejta e tyre për pronë në rastet e trashëgimisë.

Mentaliteti tradicional dominues në Kosovë si dhe balanci social mund të observohen kur flasim për arsimin. Llogaritet se 14 përqindje e grave rurale krahasuar me 4 përqindje të burrave rural janë analfabetë në Kosovë. Sa i përket arsimit të grave, rrethanat financiare, kulturore dhe faktorët tjerë kanë dërguar deri te kjo gjendje shqetësuese.


Gratë ende nuk kanë qasje ndaj kujdesit shëndetësor kualitativ në Kosovë. Spitalet dhe shumica e qendrave shëndetësore janë në një gjendje të keqe. Indikatorët e shëndetit amënor, paralindjes, foshnjës dhe fëmijës janë të dobëta në krahasim me pjesën tjetër të Evropës. Shkalla e lartë e mortalitetit amënor, paralindjes dhe foshnjeve reflekton qasje të dobët, dhe mungesë të mbrojtjes dhe shërbimeve kualitative shëndetësore.

Sa i përket sigurisë bazike njerëzore, është fatkeqësi që shteti dhe shoqëria nuk ofrojnë as mbrojtjen bazike për gratë të cilat janë viktimat e dhunës. Shërbimet dhe mbrojtja e viktimave konsiderohen të pamjaftueshme. Përderisa numri zyrtar i rasteve të raportuara ende konsiderohet jo i lartë, avokuesit e të drejtave të grave vazhdimisht kanë ngritur zërin sa i përket rasteve të paraportuara, të cilat ata/ato argumentojnë se përbëjnë shumicën e rasteve.



# SIGURIA NJERËZORE

## Siguria Njerëzore 3.34



### Ilustrimi 3. Rangimet për Siguri Njerëzore në Kosovë

Rangimi total për Dimensionin e Sigurisë Njerëzore është 3.34. Kjo notë përfaqëson notën mesatare të të gjitha paneleve të ekspertëve. Nota e përgjithshme mjaft pozitive është argumentuar kryesisht sa i përket infrastrukturës ligjore (p.sh. kushtetutës dhe ligjeve) dhe dispozitave të caktuara në to. Duhet të përmendet se ekipi i projektit ka përdorur dhe zgjeruar definicionin rreth sigurisë njerëzore të përdorur nga UN Women, i cili është i kodifikuar në akte të shumta ligjore dhe normative, prej të cilave UNSCR1235 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë<sup>2</sup> është një prej më të rëndësishmeve. Kjo rezolutë specifikisht adreson gjendjen e grave në konflikte të armatosura, dhe bën thirrje për pjesëmarrjen e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes.<sup>3</sup>

Përderisa të gjithë indikatorët brenda Dimensionit të Sigurisë Njerëzore janë ranguar pozitivisht nga shumica e ekspertëve, gjendja më pozitive ka

<sup>2</sup> Për më shumë informata, shihni [www.unwomen.org](http://www.unwomen.org)

<sup>3</sup> Si më lart.

---

të bëj me indikatorët 1<sup>4</sup> dhe 3<sup>5</sup> të këtij dimensionit. Me përjashtim të disa çështjeve që duket të jenë më problematike, në përgjithësi të drejtat bazike njerëzore të grave në Kosovë respektohen dhe janë edhe të garantuara me akte ligjore.

Një prej rasteve, ku të drejtat e grave shkelen veçanërisht në hapësirat rurale është votimi, ku gratë shpesh votojnë të ndihmuara nga vullneti i 'burrit' të shtëpisë dhe pajtohen me praktikën familjare të votimit. Si shënim tjetër, një prej ekspertëve në panelin e Shoqërisë Civile tregon raste në disa gjyqe kosovare, në të cilat për llojin e njëjtë të krimit, varësisht nga gjinia e viktimave, aplikohen nivele të ndryshme të dënimit. Përveç këtyre dy shembujve tjerë negativ të shkeljeve të drejtave njerëzore, shumica e diskutimeve mbi këta indikatorë ka qenë mjaft pozitiv.

Sipas ekspertët, gjendja e Indikatorëve 2<sup>6</sup> dhe 4<sup>7</sup> të Dimensionit të Sigurisë Njerëzore, është larg më negative sesa për ato 1 dhe 3. Të gjithë ekspertët pajtohen se trafikimi nuk është fenomen i tolerueshëm nga standardet kosovare dhe në përgjithësi dënohet. Ekspertët gjithashtu thonë se prostitucioni është prezent në Kosovë dhe se të gjithë përdoruesit e seksit komercial aplikojnë standarde të dyfishta, duke dënuar trafikimin si fenomen, por në të njëjtën kohë, përdorin këto shërbime.

Edhe pse të gjithë ekspertët pajtohen se ligji nuk diskriminon gratë, aplikimi i këtyre dispozitave ligjore në praktikë nuk është në nivelin e dëshirueshëm. Burimi i këtij diskriminimi sipas ekspertëve është standardi i dyfishtë moral që aplikohet kundrejt burrave dhe grave.

Aspekti më shqetësues i diskutuar nga të gjitha panelet e ekspertëve ka të bëjë me dhunën familjare dhe efektin në gjendjen e përgjithshme shoqërore në Kosovë. Ekspertët vazhdimisht kanë argumentuar gjatë diskutimeve se strehët për viktimat e dhunës janë të pamjaftueshme, dhe shpesh financiarisht jostabile. Mungesa e mbrojtjes nga shteti dhe aspekti kulturor i grave të shkurorëzuara të njollosura nga familjet e tyre dhe nga shoqëria në përgjithësi, besohet të jetë arsyeja kryesore për mosraportimin e rasteve të dhunës familjare. Për më tepër, pjesëmarrësit në panelet e ekspertëve

---

4 Indikator 1: Jeta e grave garantohet me ligj/kushtetutë dhe ka vlerë të barabartë me atë të burrave. Shteti respekton jetën njerëzore barabartë pavarësisht gjinisë.

5 Indikator 3: Gratë kanë të njëjtat të drejta kushtetuese si burrat duke përfshirë të drejtën për votë, për pronë dhe punësim.

6 Indikator 2: Gratë janë të lira të zgjedhin fatin e tyre dhe të jetojnë jetë më dinjitet, të lira nga trafikimi apo të detyruara në punë skllavërore. Shoqëria përgjithësisht dënon trafikimin dhe punën e detyruar. Gratë janë të lira të jetojnë jetën e tyre të pavarura dhe të mos detyrohen në trafikim.

7 Indikator 4: Gratë trajtohen me kodin e njëjtë moral si burrat. Ligji ndalon diskriminimin e grave.




---

gjithashtu kanë thënë se presioni shoqëror dhe dhuna psikologjike kundër grave të cilat raportojnë dhunën familjare është e lartë dhe dekurajon shumë gra ta bëjnë këtë.

# SIGURIA EKONOMIKE

## Siguria ekonomike 4.16



### Ilustrimi 4. Rangimi i Sigurisë Ekonomike nga Grupet

Ky dimension rangohet me notat më të ulëta nga të gjithë, nga të tri panelet e ekspertëve. Edhe pse ekspertët pranojnë se Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet tjera aplikojnë trajtim të barabartë për burra dhe gra, në praktikë nuk ndodh kjo. Ekspertët unanimisht pajtohen se ky dimension është më problematiku dhe gjithashtu përshkruajnë atë si burimi për notat e ulëta në dimensionet tjera.

Disa nga të dhënat në dispozicion tregojnë se vetëm 13përqindje e grave në Kosovë jetojnë prej të hyrave vetanake, përderisa përqindja e burrave në kategorinë e njëjtë është 41përqindje. Këto shifra shqetësuese flasin për 87përqindje të grave të cilat janë të varura financiarisht nga familjet dhe bashkëshortët e tyre për mbijetesë, dhe të cilat si rezultat janë më të rrezikuara ndaj të gjitha formave të diskriminimit.<sup>8</sup> Papunësia, e cila për gratë e Kosovës është regjistruar të arrijë një total prej 68përqindje të grave aktive për punë, është gjithashtu fenomen shqetësues.<sup>9</sup>

Ekspertët besojnë se gratë diskriminohen në tregun e punës dhe përballen me konkurrencë jo të drejtë nga burrat. Shpesh bizneset private specifikojnë moshën dhe gjininë në përshkrimin e vendeve të punës, përkundër dispozitave

<sup>8</sup> Valur Ingimundarson. Nën patriarkalizëm dhe paqeruatje: Gratë në Kosovë që nga lufta. <http://www2.hi.is/page/RIKK-womeninkosovo>.

<sup>9</sup> Zymberi Fikrije. Korniza Kombëtare për Kualifikim e Kosovës dhe Punësimi i të Rinjve, MASHT, 2008.

---

të qarta ligjore kundër kësaj. Përderisa nuk ka dallim të dukshëm në pagë për të dy gjinitë, panelistët shprehin shqetësimin e tyre se Ligji i ri i Punës do të jetë burim diskriminimi ndaj grave. Dispozitat lidhur me pushimin e lehonisë të përcaktuara në ligj mund të bëhen pengesa kryesore për gratë e reja që të punësohen, pasi që pritet se punëdhënësit privat do të hezitojnë të punësojnë gra të reja, të cilat përfaqësojnë nëna potenciale. Edhe pse aktualisht nuk ka dëshmi të prezencës së diskriminimit gjinor për shkak të dispozitave të Ligjit të Punës rreth pushimit të lehonisë, shumica e panelistëve gjatë diskutimeve kanë argumentuar se defnitivisht kjo përfaqëson një sfidë për Inspektoratin e Punës dhe institucionet tjera përgjegjëse për sigurimin e barazisë...

Sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, të drejtat e trashëgimisë garantohen njëjtë si për burrat ashtu edhe për gratë. Megjithatë, në praktikë, kryesisht për shkak të presionit shoqëror, shumicës së grave kosovare u mohohet e drejta pronësore në favor të vëllait. Indikatorët 5<sup>10</sup> dhe 6<sup>11</sup>, të cilët mbulojnë të gjitha këto aspekte, janë ranguar nga ekspertët më keq nën këtë dimension.

Një indikator tjetër që duhet të përmendet në këtë dimension është numri 8<sup>12</sup>, i cili mbulon të drejtat e alimonisë dhe zbatimin e tyre. Ngjashëm me aspektet tjera nën këtë dimension, ekziston një mospërputhje mes dispozitave ligjore dhe gjendjes në praktikë. Të drejtat e alimonisë për gratë e shkurorëzuara garantohen me ligj në Kosovë, por nuk ka mekanizma funksional për të siguruar zbatimin e tyre në praktikë. Përkundrazi, pagesa e obligimeve të alimonisë mbetet në vullnetin e mirë të partnerit.

---


10 Indikator 5: Gratë kanë qasje të barabartë në tregun e punës me burrat dhe marrin pagë të barabartë me burrat për të njëjtën pozitë.

Punëdhënësit publik dhe privat nuk diskriminojnë në bazë të gjinisë dhe nuk specifikojnë gjininë gjatë punësimit..

11 Indikator 6: Gratë kanë të drejta të trashëgimisë dhe mund të hyjnë në transaksione financiare/komerciale me pronë. Nuk ekzistojnë pengesa kulturore për gratë që të hyjnë në transaksione të tilla.

12 Indikator 8: Ligjet familjare sigurojnë mbështetje për gratë e shkurorëzuara si dhe pasurinë e gjeneruar gjatë martesës (para shkurorëzimit). Nuk ekzistojnë pengesa kulturore apo ligjore që gratë të ushtrojnë këto të drejta.

## ARSIMI



**Ilustrimi 5. Rangimet e Arsimit nga Grupet**

Arsimi është dimension i ranguar më së larti, por ende mbetet hapësirë për përmirësim. Sipas ekspertëve pjesëmarrës në panele, sistemi Kosovar i arsimit është në rrugë të mirë por ende nuk ka arritur aty ku duhet. Analfabetizmi është ende prezent tek gratë (më shume sesa tek burrat), dhe shumë pak është duke u bërë për ta luftuar këtë fenomen të braktisjes së shkollës nga vajzat e reja. Para ligjit, të drejtat për arsim janë të garantuara si për gratë ashtu edhe për burrat, por në praktikë braktisja e shkollës më shpesh ndodh tek vajzat sesa tek djemtë. Diskutimi rreth këtij indikator në shumicën e paneleve është fokusuar në nevojën për të zhvilluar dhe praktikuar metoda dhe mekanizma në dispozicion për të luftuar efektivisht fenomenin e braktisjes së shkollës dhe analfabetizmit tek gratë dhe vajzat e reja.

Si pikë tjetër, panelistët konsiderojnë se sistemi arsimor në Kosovë është i barabartë sa i përket vlerësimit dhe performancës së djemve dhe vajzave. Nuk ekziston diskriminim sistemor kundër grave në sistemin arsimor që do të pengonte regjistrimin e tyre dhe performancën vijuese. Gjithashtu, ekspertët pajtohen se gratë mund të ndjekin karriera dhe të arrijnë nivelet më të larta të zhvillimit arsimor. Përkundër barazisë në sistemin arsimor, faktorët kulturor dhe social perceptohen të jenë faktorët kryesor që shkaktojnë analfabetizëm aq të lartë mes grave. Për shkak të faktorëve ekonomik, përfitimi relativ nga arsimimi i djemve (të cilët normalisht mbeten të jetojnë me prindërit e tyre) dhe vajzave (që shumica martohen dhe largohen nga familja), dhe faktorë


---

tjerë kulturor të cilët janë burimi i këtij diskriminimi të përhapur kundër grave në arsim.

Mosmarrëveshja e vetme brenda Dimensionit të Arsimit ka të bëjë me lirinë e zgjedhjes dhe qasje të barabartë në të gjitha profesionet. Përderisa ka pasur ekspertë të cilët besojnë se gratë janë të lira të zgjedhin orientimin e tyre profesional, kishte gjithashtu të tjerë të cilët konsideronin se ende disa nga pozitat/profesionet e paguara dobët 'rezervohen' për gratë. Disa nga këta shembuj përfshijnë mësimdhënien në shkollimin parafillor dhe fillor, një sektor i dominuar nga gratë.

# SIGURIA SOCIALE DHE SHËNDETI

## Sigurimet Shoqërore dhe shëndeti 3.34



### Ilustrimi 6. Siguria Sociale dhe Shëndeti nga Grupet

Dimensioni i Sigurisë Sociale dhe Shëndetit është ranguar nga ekspertët me 3.36. Ngjashëm me dimensionet e tjera, rangimi më optimal është dhënë nga përfaqësuesit e institucioneve dhe rangimi më negativ nga shoqëria civile. Indikatorët më të ranguar në këtë dimension janë numrat 15<sup>13</sup> dhe 16<sup>14</sup>. Shumica dërmuese e panelistëve në të gjitha diskutimet duket se pajtohen se nuk ekziston diskriminim gjinor sa i përket benefiteve të sigurimit social, si në para të gatshme ashtu edhe në kontribute. Për më tepër, që nga fillimi i 2011, legjislacioni kosovar është pasuruar me një ligj të rëndësishëm që qeveris marrëdhëniet punëtor-punëdhënës. Dispozitat në këtë ligj garantojnë pushim të lehonisë me pagesë për gratë për një periudhë prej 6 muajsh, me një pushim opcional 6 muaj me pagesë të reduktuar/pjeshme. Megjithatë duhet të përmendet se kishte një dozë të skepticizmit mes panelistëve rreth ndikimit negativ të këtij ligji (pushimit të lehonisë më specifiku) lidhur me punësimin e grave.

Si pikë negative, mendimi i përhapur i paneleve të ekspertëve është se gratë nuk janë tërësisht të lira të marrin vendime sa i përket trupit të tyre. Kjo

13 Indikator 15: Gratë nuk diskriminohen në përfitimet e sigurimit social duke përfshirë pensionet, paaftësimin, pensionet e mbijetesës/efamiljar, etj.

14 Indikator 16: Gratë gëzojnë të drejtën për pushim të lehonisë me pagesë nëse shtatzënia ndodh gjatë kohës së punësimit.


---

është argumentuar të jetë rasti sidomos për gratë e martuara në hapësirat rurale, ku ato nuk lejohen as të shkojnë tek gjinekologu pa përcjelljen e një anëtari tjetër të familjes së burrit. Tema e prekur në të gjitha diskutimet dhe e karakterizuar si shqetësuese ka të bëjë me abortin. Është mendimi i shumicës së panelistëve se në familje më tradicionale gratë nuk mundën lirisht të zgjedhin të bëjnë abort të fëmijëve të padëshiruar/paplanifikuar.

Panelistët gjithashtu deklarojnë se jo të gjitha gratë në Kosovë kanë qasje të lirë dhe të lehtë ndaj gjinekologut dhe onkologut. Kjo vlen sidomos për hapësirat rurale dhe të largëta, ku shërbimet e specialuzara shëndetësore nuk janë të disponueshme në institucionet publike shëndetësore. Për më tepër, edhe në spitalet rajonale ku shërbime të tilla duhet të ofrohen, për shkak të sjelljes joetike të mjekëve dhe kushteve të dobëta të pajisjeve, shpesh këto shërbime nuk ofrohen. Në rrethana të tilla gratë nga familjet me të hyra të ulëta privohen nga këto shërbime. Disa nga panelistët kanë dhënë edhe shembuj të grave të cilat janë shkurorezuar, sepse bashkëshortët e tyre kanë zbuluar se ato kanë abortuar.

# PËRFSHIRJA POLITIKE DHE INSTITUCIONALE

## Përfshirja Politike dhe Institucionale 3.15



### Ilustrimi 7. Rangimet e Përfshirjes Politike dhe Institucionale nga Grupet.

Dimensioni i fundit i ranguar gjatë kohës së këtij ushtrimi ishte ai i përfaqësimit politik dhe institucional të grave. Dimensioni ka marr disa nga rangimet më pozitive nga të gjithë dimensionet. Arsyeja për notimit të tillë është kuota gjinore e rezervuar në strukturat politike dhe administrative (Parlamenti, administrata, etj.), përderisa panelistët në përgjithësi kanë shprehur nivel të kënaqshëm të përfaqësimit të grave në pozitë vendimmarrëse. Si është thënë në seksionin e gjendjes aktuale, periudha raportuese ka vënë në qendër të vëmendjes disa gra në zhvillimet politike dhe institucionale. Kryesisht për shkak të arsyeve të tërthorta (të cilat nuk minojnë rezultatet finale), Kosova ka zgjedhur presidenten e parë grua, duke u bërë kështu shteti i parë në rajon për të vënë një shembull të tillë. Udhëheqësja e delegacionit të Kosovës, e cila e udhëheq dialogun me Serbinë është znj. Edita Tahiri, një aktiviste e njohur e grave, e cila gjithashtu është anëtare e Lobit Rajonal të Grave. Gruaja e tretë në pozitë të pushtetit e cila ka qenë



---

në qendër të zhvillimeve politike është Zv.kryeministrja znj. Mimoza Kusari-Lila,, e cila bëri thirrje për masa reciprociteti kundër Serbisë, dhe për pasojë filloi një prej përpjekjeve më serioze të Qeverisë së Kosovës për të vënë tri komonat e saja veriore nën rendin kushtetues të Kosovës që nga shpallja e Pavarësisë.

Përderisa të gjithë panelistët me të drejtë i njohin rolet që këto gra kanë luajtur në proceset e rëndësishme të Kosovës, ata gjithashtu thonë se më mirë do të ishte nëse këto gra do të zgjedheshin në këto pozita, jo për shkak të ndikimeve të zyrave ndërkombëtare në Kosovë, por si rezultat i vullnetit të njerëzve dhe si normë e pranuar përgjithësisht. Edhe pse mund të ketë pengesa kulturore dhe sociale për gratë rurale të garojnë dhe të zgjedhën për zyra publike, panelistët thonë se gjendja për politikanet aktuale gra është tërësisht e ndryshme. Një prej panelistëve nga Komisioni Qendror Zgjedhor i Kosovës përshkruan se udhëheqësit e kampeve elektorale për shumicën e kandidatëve gra në zgjedhjet e fundit, kanë qenë burrat e tyre. Sipas tyre, ky fenomen është dëshmi se, të paktën në familjet më progresive, gratë janë të lira të vendosin për të krijuar karrierë politike dhe institucionale.

Sa i përket degëve dhe niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe përfaqësimit të grave në to, panelistët ofrojnë shembuj të mospërmbushjes së kuotave në shumë institucione, duke përfshirë gjyqësorin, qeverisjen lokale, dhe qeverisjen qendrore. Parlamenti është dega e vetme e qeverisjes që tërësisht respekton kuotat e rezervuara për gra sipas Ligjit për Zgjedhjet. Është e rëndësishme të përmendet se shumica dërrmuese e panelistëve është në favor të përfaqësimit gjinor të kuotave në Kosovë, pasi që e shohin këtë si bartëse që në të ardhmen do të simuloj përfshirje më të madhe të grave në jetën politike dhe institucionale. Përkundër pranimeve se kualiteti i përfaqësimit të grave jo domosdoshmërisht sigurohet përmes kuotave dhe se në të kaluarën parlamentaret gra nuk kanë bërë aq shumë në avancimin e të drejtave të grave në parlament, argumenti më i zëshëm në diskutime ishte se pasi të krijohet kultura e pjesëmarrjes, vazhdon konkurrenca.

### Sfondi i Projektit

Indeksi i Sigurisë së Grave (ISG) është zhvilluar nga IQ Consulting dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe përfaqëson një vegël të standardizuar për matjen e nivelit të Sigurisë së Grave në shtete të ndryshme. ISG-ja ofron perspektiva krahasuese horizontale (mes shteteve) të 4 dimensioneve, secila prej të cilave vlerësohet duke u bazuar në 6 indikatorë. Indeksi shtetëror prodhohet duke gjetur mesataren e vlerave të këtyre 24 variableve me nivel të barabartë të rëndësisë.

ISG-ja konceptohet si vegël e matjes periodike që gjithashtu mund të përdoret për monitrimin e progresit/regresit me kohë. Ideja për zhvillimin e këtij hulumtimi dhe veglës së monitorimit është iniciuar nga Indeksi i Qëndrueshmërisë së OJQ-ve nga USAID, që për qëllim ka monitorimin e shëndetit të shoqërisë civile në shtetet në tranzicion (në Evropë dhe Euroazi). Metodologjia e ISG-së bazohet në të njëjtën logjikë të OJQ SI, por është modifikuar dhe adaptuar tërësisht për t'u përshtatur me specifikat e sigurisë së grave. Bazat për zhvillimin e indikatorëve specifik, që së bashku (në grupe prej 6) përbëjnë dimensionet (5 në total), ka qenë lista e sugjeruar e indikatorëve për monitorimin e UNSCR 1325.

Metodologjia e ISG-së është zhvilluar si pilot projekt. Projekti është porositur nga Grupi Koordinues për Siguri dhe Çështje dhe është financuar nga UN Women. Metodologjia merr në konsideratë specifikat në terren (situata në Kosovë), por aplikon standarde të pranura univerzalisht të sigurisë së grave të kodifikuara në formën e një Rezolute UNSCR 1325. Metodologjia mund të implementohet në secilin shtet, por mund të ketë nevojë për adaptime të vogla.

KGSC-ja dhe IQ Consulting synojnë të implementojnë metodologjinë e Indeksit si vegël e matjes vjetore që shërben për matjen e saktë të progresit/regresit në fushën e sigurisë së grave. Për më tepër, vegla është konceptuar të

---

ofrojë krahasime horizontale mes shteteve të ndryshme, në këtë mënyrë duke promovuar suksesin e arritur në sigurinë e grave në shtete të ndryshme.

## Qëllimi dhe Shfrytëzimi

Qëllimi i ISG-së është të ofrojë një vegël për matjen e progresit/regresit të sigurisë së grave përgjatë 24 parametrave të ndryshëm. Është dizajnuar të jetë i përshtatshëm për aplikim nga OJQ, INGO, IGO ose qeveri nacionale që synojnë monitorimin e përmirësimeve/përkeqësimeve të sigurisë së grave. ISG-ja është posaçërisht i përshtatshëm për matjen e progresit të bërë në implementimin e 1325. Bazuar në këtë shpjegim, Indeksi i Sigurisë së Grave do të ishte jashtëzakonisht i dobishëm për organizata si UN Women Fund, që në një pjesë të mirë të vendeve në zhvillim ka një program të sigurisë së grave.

Në mënyrë që të sigurohet paanësia e entitetit/organizatës implementuese, metodologjia e ISG-së kërkon që të bëhen tri panele të ekspertëve me rëndësi të njëjtë, një prej secilës:

- Përfaqësues të shoqërisë civile,
- Përfaqësues të institucioneve publike
- Përfaqësues të medias

Ky ndërtim/vendosje logjike e metodologjisë së ISG, që kërkon input të tri audiencave të synuara, e bën indeksin më përfshirës në dukje, të besueshëm dhe vegël e pranueshme për audiencat më të gjera.

Për shkak të fleksibilitetit që metodologjia e indeksit ofron, ai mund të përdoret gjithashtu si vegël e hulumtimit bazë për projekte që fokusohen në sigurinë e grave dhe/ose akterët e shoqërisë civile që avokojnë për të drejta dhe siguri të grave.

Metodologjia e ISG-së është posaçërisht e përshtatshme për organizata dhe rrjete rajonale që implementojnë programe dhe projekte në më shumë se një shtet, pasi që mund t'iu ofrojë organizatave të tilla një perspektivë krahasuese të situatave në shtetet përkatëse, dhe si rezultat, e bënë programimin dhe planifikimin e aktiviteteve më të lehtë.

---

## Fushëveprimi

Fushëveprimi i ISG-së është i gjerë dhe bazohet në një mesatare aritmetike të 24 variableve/indikatorëve të ndryshëm të shpërndarë përgjatë 4 Dimensioneve. Baza për zhvillimin e indikatorëve ka qenë udhëzuesi i UNSCR 1325 për monitorimin e 1325 dhe grupimi sipas dimensionit është bazuar në llojin e sigurisë. Logjika e ISG-së bazohet në një definicion katër dimensional të sigurisë që merr parasysh pesë (sipas autorëve) llojet më të rëndësishme të sigurisë:

- Sigurinë njerëzore
- Sigurinë ekonomike
- Dimensionin e arsimit (siguri e ardhshme)
- Siguria sociale dhe shëndeti
- Përfaqësimi në vendimmarrje (përfshirja politike dhe institucionale)

Gjeografikisht, metodologjia e ISG-së është e aplikueshme univertalisht në të gjitha shtetet e botës. Dimensionet e përdorura për të definuar sigurinë dhe indikatorët përkatës janë të aplikueshëm univertalisht pavarësisht kulturës, nacionalitetit apo religjionit. Indeksi i ISG-së përdor vlera absolute për sigurinë e perceptuar të grave nga tri audienca të synuara, duke e bërë kështu ISG-në të aplikueshme/replikueshme në të gjitha shtetet me qeveri formale dhe tri degë të qeverisjes. Adaptime të vogla mund të jenë të nevojshme për të minimizuar paragjykimin kulturor në anën e organizatës implementuese.

## Metodologjia e Projektit

Hapat në vijim duhet të ndjekën për t'i krijuar panelet e ekspertëve, për t'i definuar notimet, dhe për t'i hartuar një raport shtetëror për Indeksin Kosovar të Sigurisë së Grave 2011.

1. Përzgjidhni tri grupe me ekspertë të madhësisë prej 8-12 persona që kanë njohuri mbi çështjet e diskutuara.

Paneli i Ekspertëve #1 duhet të përbëhet nga aktivistë të shoqërisë civile

---

dhe avokues të të drejtave të grave nga sektori joqeveritar. Paneli duhet të përfshij një grup të llojllojshëm të ekspertëve të kategorive në vijim:

2-3 Përfaqësues të grupeve avokuese dhe organizatave (p.sh. grupe specialistësh, qendra hulumtimi, akademi, organizata të zhvillimit të politikave)

2-3 Përfaqësues të organizatave të shërbimeve (strehim, trajnime dhe ndërtim kapacitetesh, asociacione të grave, asociacione profesionale të grave, etj.)

2-3 Organizata me orientim biznesi që fokusohen në gra

një shumëllojshmëri të donatorëve ndërkombëtar të cilët punojnë në çështje të shoqërisë civile;

2-3 Oganizata donatore që përfshijnë sigurinë e grave në objektivat e tyre financuese.

Rekomandohet që së paku 60përqindje e Panelit të Ekspertëve #1 të jenë vendor me pjesën tjetër prej 40përqindje të përfaqësohen nga organizata ndërkombëtare që punojnë në Kosovë. Për aq sa është e mundur, pjesëmarrësit duhet të përfaqësojnë një llojllojshmëri të rajoneve: rurale, urbane dhe popullatat pakicë.

Paneli i Ekspertëve #2 duhet të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës. Paneli duhet të përfshijë një grup të llojllojshëm të ekspertëve të kategorive në vijim:

2-3 Zyrtarë të barazisë gjinore

2-3 Shërbyes civil të nivelit më të lartë nga ministrinë

2-3 Persona nga Parlamenti dhe Gjyqësori

2-3 Persona nga institucionet e qeverise lokale

Rekomandohet që së paku 80përqindje e Panelit të Ekspertëve #2 të jenë vendor me pjesën tjetër prej 20përqindje të përfaqësohen nga organizata ndërkombëtare që punojnë në Kosovë (p.sh. EULEX, ICO). Për aq sa është e mundur, pjesëmarrësit duhet të përfaqësojnë një llojllojshmëri të rajoneve dhe përfaqësues të minoriteteve. Sa i përket përfaqësuesve të qeverisë lokale, këshillohet që të sigurohet shpërndarje e llojllojshme gjeografike e pjesëmarrësve në favor të institucioneve jo me bazë në Prishtinë.

---

Paneli i Ekspertëve #3 duhet të përbëhet nga përfaqësues të medias. Paneli duhet të përfshijë një grup të llojllojshëm të ekspertëve të kategorive në vijim:

2-3 Shtypi (përfaqësues të gazetave)

2-3 TV gazetarë

2-3 Gazetarë radio dhe interneti

2-3 Përfaqësues nga botime periodike dhe revista

Në disa raste, mund të jetë e nevojshme për të zgjedhur një grup më të madh, në mënyrë që të reflektohet diversiteti dhe gjerësia e sektorit. Megjithatë, ju lutemi mbani në mend, se një grup më i madh do ta bëjë ndërtimin e konsensusit më të vështirë. Përndryshe, nëse ka dallime rajonale brenda një shteti ku Indeksi është duke u zhvilluar, është e këshillueshme që të mbahet një seri e paneleve rajonale të cilat të kombinuara mund të prodhojnë indeksin e shtetit. Nëse organizata implementuese dëshiron ta ndjek këtë qasje rajonale, metodologjia duhet të konturohet dhe të dorëzohet tek z. Kushtrim Shaipi ([kushtrim.shaipi@iqconsulting.biz](mailto:kushtrim.shaipi@iqconsulting.biz)) dhe znj. Luljeta Vuniqi ([luljeta.vuniqi@gmail.com](mailto:luljeta.vuniqi@gmail.com)) për shqyrtim dhe diskutim para marrjes përsipër të organizimit të këtyre paneleve rajonale.

2. Sigurohuni se anëtarët e panelit i kuptojnë objektivat e ushtrimit. Objektivi i secilit prej paneleve është zhvillimi i një konsensusi bazuar në rangimin për secilin prej dimensioneve të Sigurisë Gjinore nga Indeksi dhe për të artikuluar një justifikim për secilin rangim konsistent me metodologjinë e përshkruar më poshtë. Qëllimi i përgjithshëm i Indeksit është përcjellja dhe krahasimi i progresit në sektor, duke rritur aftësinë e entiteteve lokale për të ndërmarr vet-vlerësim dhe analiza. Ai gjithashtu synon të zhvilloj një ngritje të kuptimit të sektorit të OJQ-ve mes donatorëve, qeverive, dhe OJQ-ve për qëllime të mbështetjes dhe programimit më të mirë.

Ne rekomandojmë shpërndarjen e udhëzimeve dhe dokumentet e përshkrimit të rangimeve anëtarëve të Panelit të Ekspertëve minimum tri ditë para mbledhjes së tyre në panel, në mënyrë që ata/ato të mund t'i kryejnë notimet e tyre fillestare për secilin indikator para takimit me anëtarët tjerë të panelit. Kërkoni nga ata/ato që të vijnë me notimet e tyre individuale të kompletuara.

3. Mbani takime me tri Panelet e Ekspertëve. Ju rekomandojmë që të planifikoni të mbani këtë takim jo më vonë se 31 maj 2011. SHËNIM: Para

---

takimit, mblidhni rangimet individuale dhe futni ato në një dokument të formatit Excel që është përgatitur specifkisht për të llogaritur vlerat mesatare për indikator dhe dimension.

5. Pasi të jenë caktuar notimet për secilin dimension, si hap final, shqyrtoni përshkrimin e atij dimensionit në "Përshkrimet e Rangimeve". Diskutoni me grupin tuaj nëse notimi për shtetin tuaj përputhet me atë përshkrim të rangimit. Për shembull, një notë prej 2.3 në Arsim do të ishte në kategorinë 'progresive'. Ju lutemi lexoni seksionin 'progresive' për arsim në "Përshkrimet e Rangimeve" për t'u siguruar se kjo saktësisht përshkruan ambientin. Nëse jo, diskutoni me grupin tuaj për të përcaktuar një notim më të saktë që përputhet me përshkrimin për atë dimension.

6. Diskutoni secilin prej shtatë dimensioneve të Indeksit dhe notoni ato në mënyrë të ngjashme. Kur të përfundoni notimin e të gjithë shtatë dimensioneve, së bashku nxjerrni mesataren e notimit final të dimensionit për të nxjerrë notën finale të Indeksit të shtetit. Sigurohuni që të përfshini një përmbledhje të këtij diskutimi në draft raportin tuaj të shtetit.

7. Ju lutemi përkujtojeni grupin në këtë fazë se raportet do të shqyrtohen nga një Komitet Editorial (KE) të përbërë nga ekspertë të mirënjohur të të drejtave të grave. KE-ja përbëhet nga përfaqësues: OJQ, Akademia, Ekspertë vendor dhe ndërkombëtar. Roli i KE-së do të jetë më i rëndësishëm në edicionet e ardhshme të Indeksit kur shtetet tjera gjithashtu të përfshihen në ushtrim. Pastaj, KE-ja do të luajë një rol të kontrollimit të informatave në raport dhe do të prodhojë një indeks publikimi krahasues për të gjitha shtetet në ushtrim. Nëse ka dëshmi substanciale që mbështesin dyshimet rreth notimit/rangimit në një shtet të caktuar, KE-ja mund të kërkojë informata shtesë nga agjencioni implementues. Nëse KE-ja nuk ndihet se ato notime janë të mbështetura siç duhet, posaçërisht në krahasim me notimet e shteteve tjera në rajon, ato mund të ndryshohen.

8. Përgatitni një Draft Raport të Shtetit. Raporti duhet t'i përfshijë ngjarjet gjatë kalendarit vjetor (ndryshe nga ai fiskal). Drafti duhet të përfshijë një deklaratë përmbledhëse, dhe një diskutim të shkurtë të gjendjes aktuale të sigurisë së grave në lidhje me secilin dimension. Seksioni mbi secilin dimension duhet të përfshijë një diskutim si të arritjeve dhe anëve të forta në atë dimension, ashtu edhe pengesat për siguri dhe dobësitë.

9. (Vlen vetëm për Edicionin 2011 të Indeksit të Sigurisë së Grave në Kosovë) Shqyrtime nga Grupi Koordinues i Sigurisë dhe çështjeve gjinore (SGCG) që drejtohet nga UNIFEM-i, si organi i vetëm formal që ka qenë lider

---

në promovimin e sigurisë së grave në një mënyrë të integruar. Arsyetimi prapa kësaj përfshirjeje bazohet në përbërjen e grupit, kryesisht prezencës së të gjitha organizatave madhore ndërkombëtare dhe vendore (dhe institucionet e Kosovës), të cilat janë aktive në terren. Ky hap gjithashtu do të shërbejë për të ndërtuar kredibilitet të indeksit dhe për të siguruar se raporti final reflekton realitetin në terren.

Në Deklaratën Përmbledhëse, ju lutemi përfshini një numër të përlllogaritur të OJQ-ve aktive për të drejtat e grave/barazisë gjinore, si dhe një përmbledhje të fushave primare dhe hapësirave gjeografike në të cilat këto OJQ operojnë. Ju lutemi kufizoni dorëzimin tuaj për KE-në në maksimum prej pesë faqesh, në Anglisht. Ju lutemi mbani në mend se ne besojmë që organizata juaj të sigurojë që raportet të jenë në gjatësi të duhur dhe të shkruara mirë. Ne nuk kemi kapacitete për të bërë redaktim të gjerë.

Përderisa raportet individuale shtetërore, të cilat shkojnë në publikim qendror 2011 të Indeksit të Sigurisë së Grave, duhet të jenë të shkurta, ju mund të krijoni një raport më të gjerë për përdorim në shtetin tuaj. Gjithashtu, nëse dëshironi, ju mund ta shqyrtoni përkthimin e raportit në mënyrë që të shpërndahet lokalisht sa më shumë që dëshironi.



---

## **ANEKSI 1: Indikatorët për Rangim Personal**

### **Udhëzime për Panelistët:**

Tabela më poshtë është instrumenti i rangimit i përbërë nga 5 dimensione, secili me 4 indikatorë. Vlerësoni secilin indikator ndarazi, pastaj nxjerrni mesataren e vlerave për secilin indikator për të gjetur notën e dimensionit. Mesatarja e notimit të dimensioneve do të përbëjë notimin nacional. Për qëllime të saktësisë, panelistët inkurajohen të përdorin numra/rangime sa më të sakta që të jetë e mundur (duke përfshirë decimalet 1-2).

Logjika e shkallës së vlerësimit është se sa më i ulët të jetë rangimi (më afër 1) kjo tregon një sistem më të avancuar dhe praktika progresive dhe anasjelltas, sa më i lartë të jetë rangimi (më afër 7) aq më i prapambetur/diskriminues është sistemi.

Ju lutemi plotësoni rangimet më poshtë para se të paraqitet paneli. Sigurohuni se e keni kuptuar qartë se pse keni ranguar një indikator të caktuar me një rangim të caktuar. Është e dobishme të ofroni dëshmi dhe shembuj për secilën deklaratë/opinion.

### **Të dhëna administrative**

Emri i Panelistit: \_\_\_\_\_ Vendi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_ Organizata \_\_\_\_\_

Përshkrim i Indikatorëve		Rangimi
Dimensionet dhe Indikatorët		1=avancuar; 7=dobët
Dimensioni i Sigurisë Njerëzore		
Indikator 1	<i>Jeta e grave garantohet me ligj/Kushtetutë dhe ka vlerë të barabartë me atë të burrave. Shteti respekton jetën njerëzore barabartë, pavarësisht gjinisë.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 2	<i>Gratë janë të lira të zgjedhin fatin e tyre, dhe të jetojnë jetë me dinjitet, të lira nga trafikimi apo puna e detyruar. Shoqëria në përgjithësi dënon trafikimin dhe punën e detyruar. Gratë janë të lira të jetojnë jetën e tyre të pavarura dhe të mos detyrohen në trafikim.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 3	<i>Gratë kanë të njëjtat të drejta kushtetuese si burrat, duke përfshirë të drejtën e votës, të pronës dhe punësimit.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 4	<i>Gratë trajtohen nga i njëjti kod moral si burrat. Ligji ndalon diskriminimin e grave.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Dimensioni i Sigurisë Ekonomike		
Indikator 5	<i>Gratë, ashtu sikur burrat, kanë qasje të barabartë në tregun e punës dhe marrin pagë të barabartë me burra për të njëjtën pozitë. Punëdhënësit publik dhe privat nuk diskriminojnë në bazë të gjinisë dhe nuk specifikojnë gjininë gjatë punësimit.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 6	<i>Gratë kanë të drejta të trashëgimisë dhe mund të hyjnë në transaksione financiare/komerciale me pronë. Nuk ekzistojnë pengesa kulturore për gratë që të hyjnë në transaksione të tilla.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 7	<i>Ligji për Familjen garanton gratë individualisht dhe jetë të lirë nga dhuna dhe tortura nga bashkëshortët. Ligji Kundër Dhunës në Familje ekziston dhe zbatohet.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 8	<i>Ligjet familjare sigurojnë të drejtat e alimonisë për gratë si dhe pasurinë e gjeneruar gjatë martesës (para shklorëzimit). Nuk ekzistojnë pengesa kulturore apo ligjore që gratë të ushtrojnë këto të drejta.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Dimensioni i Arsimit		
Indikator 9	<i>Gratë kanë të drejtë të barabartë për arsim si burrat. Nuk ekziston analfabetizëm mes grave, dhe qeveria ka politika përfshirëse të arsimit karshi grave.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 10	<i>Nuk ekzistojnë pengesa ligjore apo kulturore për gratë që të ndjekin nivele më të larta të arsimit formal apo joformal.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 11	<i>Gratë kanë trajtim të drejtë në sistemin publik të arsimit si gjatë regjistrimit ashtu edhe në shkollim.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 12	<i>Gratë janë të lira të zgjedhin orientimin/profesionin. Nuk ekzistojnë profesione sekondare 'të rezervuara' për gratë.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Dimensioni i Shëndetit dhe Sigurisë Sociale		

Përshkrim i Indikatorëve		Rangimi
Dimensionet dhe Indikatorët		1=avancuar; 7=dobët
Indikator 13	<i>Gratë kanë të drejtë të marrin vendime sa i përket trupit të tyre dhe shëndetit në mënyrë të pavarur dhe unilateralisht, edhe nëse janë të martuara.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 14	<i>Grave u ofrohen shërbime shëndetësore gjatë shtatzënisë dhe kanë qasje të lirë kundrejt gjinekologut dhe onkologut.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 15	<i>Gratë nuk diskriminohen në benefitet e sigurimit social, duke përfshirë pensionet, paaftësimin, pensionet e mbijetesës/familjare, etj.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 16	<i>Gratë gëzojnë të drejtën për pushim të lehonisë me pagesë nëse shtatzënia ndodh gjatë kohës së punësimit.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Dimensioni i Përfshirjes Politike dhe Institucionale (përfshirja në vendimmarrje)		
Indikator 17	<i>Gratë janë të lira të ushtrojnë të drejta të asociacioneve, të organizohen në organizata formale apo joformale, të avokojnë për të drejtat dhe interesat e tyre.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 18	<i>Gratë janë të lira të votojnë dhe të votohen në zgjedhje lokale dhe nacionale. Kushtetuta dhe ligjet u garantojnë grave këto të drejta dhe nuk ekzistojnë pengesa reale që t'i ushtrojnë këto të drejta.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 19	<i>Gratë përfaqësohen në organet më të larta të vendimmarrjes në institucionet publike (gjyqësorin, ekzekutivin dhe legjislativin). Nuk ekzistojnë pengesa kulturore në ushtrimin e këtij përfaqësimi.</i>	1 2 3 4 5 6 7
Indikator 20	<i>Gratë janë të lira nga ngacmimet në institucionet publike.</i>	1 2 3 4 5 6 7

## ANEKSI 2: Lista e Pjesëmarrësve në Panelet e Ekspertëve

#	Emri	Pozita	Organizata
<b>Paneli 1: Shoqëria Civile</b>			
1	Valbona Salihu	Asociacioni i Avokatëve Norma	
2	Nafije Latifi	KCFBC "Jeta/Vita"	
3	Adem Gashi	KIPRED	
4	Shpresa Agushi	NRAEWOK	
5	Ardiana Cela	SHE-ERA	
6	Ardita Hima	QAK	
7	Flora Macula	UNWOMEN	
8	Advije Gashi	Aktiviste e grave	
9	Luljeta Vuniqi	QKSGj	
10	Nevenka Rikalo	RUKA RUCI	
<b>Paneli 2: Institucionet</b>			
11	Ibrahim Makolli	Deputet i Kuvendit të Kosovës	
12	Valdete Daka	Gjykata Supreme e Kosovës	
13	Premtime Preniqi	Komuna e Prishtinës	
14	Sylejman Sopa	Ministria e Drejtësisë	
15	Petrit Hajdari	Agjencia për Barazi Gjinore	
16	Vjosa Nimani Zylfiu	Gjykata Supreme e Kosovës	
17	Luljeta Domaniku	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës	
18	Ferinazelsufi	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale	
19	Fitore Zeneli	Agjencia për Barazi Gjinore	
<b>Paneli 3: Media</b>			
20	Leonard Kerquki	Gazeta "Express"	
21	Lindita Fetiu	Televizioni Kombëtar "Klan TV"	
22	Valbona Mehmeti	Gazeta "Koha Ditore"	
23	Minire Krasniqi	Gazeta "Kosova Sot"	
<b>Paneli 4: Grupi Kosovar i Sigurisë</b>			
24	Arbena Kuriu	OMCMR	
25	Ardita Tahiruka	Organizata Botërore e Shëndetësisë	
26	Davis Morgan	ICITAP	
27	Arianita Beqaj	ICITAP/CST	
28	Linda Sanaja	UN Women	
29	Vjollca Gjonbalaj	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë	
30	Visar Bivolaku	EUSR	
31	Daniela Bogdanova	Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë	
32	Ana-Maria Golu	Fondi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara	
33	Thomas Lamar	Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë	



